



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:202878
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05437696

2023:202879

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Armend Ahmeti, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Idrizi, në çështjen juridike të paditësit B.H. nga fshati ... Komuna Ferizaj, ndaj të paditurve T.O., T.S.1., T.T., T.S.2.dhe T.J., të gjithë nga fshati ... Komuna Ferizaj, tani me adresë të panjohur të vendbanimit, në çështjen juridike sigurim i provës, lidhur me objektin e kontestit vërtetimin e pronësisë, jashtë seancës me datën 12.03.2024, merr këtë

A K T V E N D I M

Refuzohet si i pa bazuar propozimi i paditësit për sigurimin paraprak të provës përmes dëgjimit të dëshmitarëve: S.H. nga fshati ... Komuna Ferizaj, H.J. nga fshati ... Komuna Ferizaj, S.T. dhe M.T. nga fshati

A r s y e t i m

Paditësi me datë 25.09.2023 ka paraqitur padi kundër të paditurve, me objekt kontesti vërtetim pronësie, vlera e kontestit 4,000€.

Paditësi me datë 26.02.2024, ka paraqitur propozim për sigurim paraprove, lidhur me vërtetimin e pronësisë në ngastrën kadastrale nr. ...-2 në sipërfaqje prej 4008 m² në vendin e quajtur ‘.... ZK P., pasi që paditësi e ka në posedim si pasojë e shitblerjes së babait të tij me prindin e tani të paditurve. Në propozimin për sigurimin e paraprovës ka propozuar që të sigurohet prova me marrjen në pyetje të dëshmitarëve S.H., H.J., S.T. dhe M.T. që të gjithë nga fshati ... Komuna Ferizaj, për shkak se personat e lartëcekur janë në moshë të shtyer dhe kanë njohuri për shitblerjen e vitit 1960 dhe kjo do t’i kontribuonte sqarimit të gjendjes faktike lidhur me objektin e kontestit.

Gjykata pas shqyrtimit të propozimit të njëjtin e refuzon si të pa bazuar për shkak se paditësi me asnjë provë nuk ka arritur t'ia vërtetojë gjykatës se këta dëshmitarë çfarë moshe janë ose ndonjë rrethanë që do të vërtetonte se të njëjtët nuk do të mund të jenë të qasshëm gjatë procesit të rregullt kontestimor në të cilin do të mund të dëgjohen në cilësi të dëshmitarëve, prandaj në këtë fazë gjykata vlerëson se propozimi është i pa bazuar dhe me të drejtë të njëjtin e refuzon. Propozimit nuk i është bashkangjitur ndonjë kartë e identitetit të dëshmitarëve, as dëshmi mjekësore mbi gjendjen e tyre shëndetësore e kështu me radhë.

Neni 379 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) thekson: “Kur një provë, nga e cila varët zgjidhja e kontestit ose që ndikon në sqarimin e tij, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet marrja e saj, me kërkesën e palës se interesuar mund të urdhërohet marrja para kohë e saj, qoftë gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor qoftë para fillimit të tij.”

Neni 381 i LPK përcakton se: “Në kërkesën për sigurimin e provës duhet të tregohen prova që do të merret, rrethanat dhe faktet për vërtetimin e të cilave shërben ajo dhe arsyet që e justifikojnë marrjen e saj përpara se të vijë koha normale për marrjen e provave. Në kërkesë duhet të tregohet emri dhe mbiemri i palës kundërshtare, përveç kur ajo është e panjohur.”

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 142 lidhur me nenin 379 e në lidhje me nenin 383.4 dhe 387.1, pika (b) të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 12.03.2024

Gjyqtari,
Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së tij, në Gjykatën e Apelit e Kosovës, nëpërmjet të kësaj gjykate.